



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1089/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet në nivel institucional Kolegji UBT dega në Pejë.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit që kanë akreditim valid në Kolegji UBT dega në Pejë për vitin akademik 2024/2025 deri në përfundimin e procesit të ri të akreditimit.
- III. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M I

Kolegji UBT dega në Pejë ka parashtruar kërkesë me Nr.prot. 1536/23, datë 31.10.2023, në Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për akreditim në nivel institucional.

Me qëllim të vlerësimit në nivel institucional AKA me datë 09.02.2024 ka organizuar vizitën me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Elene Jiblatze, Peter Parycek dhe Horia Onita.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji UBT dega në Pejë është vlerësuar se përmbushë: Substancialisht tre (3), kurse Pjesërisht tetë (8) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 123 të mbajtur më 20.05.2024 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit UBT dega në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Referuar kësaj që u tha më lartë dhe raportit final nga Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë), KShC konstatoi se Kolegji UBT dega në Pejë ka dështuar të përmbushë fushat e standardeve të përcaktuara në Manualin e Akreditimit.

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit UBT dega në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Superior të Qëndrësë